

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	UEFA dënon Crvena Zvezdën dhe Borac Banjallukën pas homazheve për Ratko Mlladiç
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/uefa-denon-crvena-zvezden-dhe-borac-banjalluken-pas-homazheve-per-ratko-ml-i584207
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 06:57:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 07:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1beb436689d5a9dccd8ed068f25441a6f750368a8c1fe8a477090ecdb4238681
TEKSTI	3d28c395e1d67c6b1cd0b13814d4ab7da3181c945893e6cd14f3bbc64f2777d4
PAMJA	31de7657bfe35e656c121b9cfff0f4f7b1faed2b6cac165c05f51af945916ca3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	de12ff13186c9d3816a2288ab0366b3985b0d1590e887fcca952cdb212565be8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06228d72b62d721da89ad9d8f88b641ef39e753d7557342e2aba3a1beafa7f90
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmaU9TuouoiwTpN4nNecxQMcyu59TjNs8nteVzFNNQZ8Qt



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/de12ff13186c9d3816a2288ab0366b3985b0d1590e887fcca952cdb212565be8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Zjarr ne hyrje te Syrit te Kalter, digjen 4 kioska private! Dyshimet e para Rama per balle 300 pyetjeve, nga Sazani te SPAK dhe pasardhesi: Nuk kam ndermend ta zgjedh Dja fundit](#)

UEFA dënon Crvena Zvezdën dhe Borac Banjallukën pas homazheve për Ratko Mlladiç



6 Shtator 2026, 09:05 Sport TEMA



Federata Evropiane e Futbollit (UEFA) ka dënuar klubin Crvena Zvezda të Beogradit dhe Borac Banjalluka për sjelljen raciste të tifozëve të tyre, pasi në ndeshjet e këtyre klubeve në garat evropiane iu bë homazh Ratko Mlladiqit, të dënuarit për gjenocid dhe krime të tjera të luftës.

Në ditën e vdekjes së Mlladiqit më 27 gusht, tifozët e Zvezda-s në ndeshjen kundër klubit futbolistik, Viktoria Plzen në Çeki shpalosën pankarta me mbishkrimin "Gjeneral, lavdi e madhe dhe faleminderit", ndërsa brohoritën emrin e Ratko Mlladiqit. Për këtë arsye, Qendra Përkujtimore e Srebrenicës kërkoi nga UEFA që ta përjashtojë përgjithmonë klubin nga Beogradi.

Komisioni Disiplinor i UEFA-s njoftoi se Crvena Zvezda është dënuar me një gjobë prej gati 100.000 eurosh për sjellje raciste dhe brohoritje të papërshtatshme nga tifozët, si dhe me ndalimin e shitjes së biletave për tifozët e saj për ndeshjen e radhës si mysafir në një garë evropiane.

Gjatë ndeshjes, tifozët e klubit të Beogradit shpalosën pankarta me mbishkrimin "Gjeneral, lavdi e madhe dhe faleminderit", ndërsa brohoritën emrin e Ratko Mlladiqit. Më pas, FK Crvena Zvezda publikoi në profilet e saj zyrtare në rrjetet sociale fotografi ku pankartat në fjalë shihen qartë.

Për shkak të sjelljes raciste dhe/ose diskriminuese të tifozëve, Zvezda u gjobit me 40.000 euro, ndërsa për transmetimin e një mesazhi të papërshtatshëm për një ngjarje sportive u gjobit me 50.000 euro. Klubi u gjobit edhe me 8.250 euro për sjelljen e pahijshme të ekipit gjatë ndeshjes si mysafir në Plzen.

Në ndeshjen e Borac Banjalluka kundër Vikingur Reykjavik, më 27 gusht, në ditën e vdekjes së Mlladiqit, në tribunat e stadiumit të qytetit në Banjallukë iu bë homazh Mlladiqit.

Komisioni Disiplinor i UEFA-s njoftoi se klubi nga Banjalluka, për shkak të sjelljes raciste dhe/ose diskriminuese të tifozëve, është dënuar me 30.000 euro, ndërsa është urdhëruar mbyllja e pjesshme e stadiumit për ndeshjen e radhës të Borac-it në një garë evropiane.

Borac është dënuar edhe me 4.000 euro për sjelljen e pahijshme të ekipit, me 3.500 euro për ndezjen e mjeteve piroteknike, ndërsa anëtar i stafit teknik, Bogolub Zheleznikov, është dënuar me 2.000 euro për fyerjen e zyrtarit të ndeshjes.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Partizani merr një fitorë të rëndësishme në transfertë kundër Vllaznise](#)

21:05 Sport / 1 koment

Ronaldo dhe Messi në një skuadër? Ish-shoku i tyre kërkon të bashkojë ikonat e futbollit në klubin legjendar

20:15 Sport

Barcelona zgjedh pesë kapitenët për sezonin e ri, surpriza është Lamine Yamal

18:05 Sport

Champions - Mourinho me dhimbje koke, 3 lojtarë mungojnë ndaj Interit

17:25 Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.